

MIRËMBAJTJA PROBLEMATIKE E RRUGËVE

VONESAT DHE FAVORIZIMET

2019



RAPORTI I MONITORIMIT TË KONTRATËS PËR MIRËMBAJTJEN VERORE DHE DIMËRORE TË RRUGËVE NACIONALE DHE REGJIONALE TË KOSOVËS 2017, 2018 DHE 2019

2019

COPYRIGHT © 2018.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Autore: Fjolla Uka

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasades Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Ambasadës Britanike në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE DHE SQARIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	9
METODOLOGJIA.....	10
TRANSPARENCA E MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS NË PROKURIM PUBLIK	11
ANALIZË E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	13
Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi	13
Siguria e Tenderit	15
Siguria e ekzekutimit.....	15
Procedura e tenderimit / ankesat.....	16
Procedura emergjente pa publikim të njoftimit për kontratë	17
Procedura e vlerësimit / ankesat	17
VLERËSIMI I KONTRATAVE	21
Regjioni Prishtina 1	21
Regjioni Prishtina 2.....	22
Regjioni Prizreni 1	23
Regjioni Prizreni 2.....	24
Regjioni Ferizaj 1	25
Regjioni Ferizaj 2	26
Regjioni Gjilani 1	27
Regjioni Gjilani 2	28
Regjioni Mitrovica 1	29
Regjioni Mitrovica 2.....	30
Regjioni Gjakova 1	31
Regjioni Gjakova 2	32
Regjioni Peja 1	33
Regjioni Peja 2	33
ANALIZË E KONTRATAVE.....	36
KRAHASIMI I OPERATORËVE PERFORMUES TË KONTRATËS SË VITIT 2014-2017 DHE KONTRATËS 2017/18/19	38
Kontrata emergjente - Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	40
KONKLUSIONE.....	43
REKOMANDIMET PËR MI.....	45
REKOMANDIMET PËR OSHP	46



LISTA E SHKURTESAVE DHE SQARIMEVE

DT	Dosja e Tenderit
LPP	Ligji për Prokurim Publik
MI	Ministria e Infrastrukturës
AK	Autoritet Kontraktues
OE	Operator Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
RRUOP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik
Performues i kontratës	Operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë
OE i papërgjegjshëm	Operatori ekonomik që nuk ka përmbushur kriteret e kërkuara në DT
Tenderues i pasuksesshëm	Operatori ekonomik i përgjegjshëm por jo i shpërblyer me kontratë
Njësi	Artikull apo pozicion specifik për të cilën është kërkuar ofertë me çmim individual
LOT	Një numër njësish të një artikulli, një artikull të vetëm, ose një paketë artikujsh të ofruara si një artikull apo shërbim i vetëm



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të angazhimit në monitorimin e prokurimit publik gjatë shtatë viteve të fundit ka monitoruar procesin e dhënies dhe mbikëqyrjes së kontratave nga Ministria e Infrastrukturës (MI). Sipas Ligjit nr. 2003/11 për rrugë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120 dhe Ligjin nr. 06/L-068, Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e autoudhës, rrugëve nacionale dhe atyre rajonale.¹ KDI ka monitoruar Kontratën për Mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale të vitit 2014, për të cilën ka dalë me raport vlerësues dhe rekomandime në vitin 2016². Me qëllim të përcjelljes nëse rekomandimet tona janë adresuar nga MI gjatë viteve në vazhdim dhe për kontrata tjera, dhe gjithnjë me synimin që të adresohet shpenzimi sa më i mirë i parasë publike, KDI edhe këtë herë ka zgjedhur ta monitorojë procesin e tenderimit për kontratën trevjeçare për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale për vitet 2017, 2018 dhe 2019. Në këtë raport është analizuar procesi i prokurimit duke filluar nga faza e planifikimit, faza e tenderimit - kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit (DT), faza e shpërblimit si dhe ankesat e operatorëve dhe vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) lidhur me këto ankesa. Gjithashtu në këtë raport trajtohet edhe kontrata emergjente me procedurë të negociuar për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve (2017-2018) si dhe kontrata e kaluar për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve (2014-2017) me qëllim të krahasimit me kontratën aktuale.

Kontrata për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale 2017, 2018 dhe 2019 me numër prokurimi 205-17-4559-2-1-1, është Kontratë publike kornizë me disa operatorë, për periudhë kohore 36 muaj.³ Vlera e kësaj kontrate është 17.231.050,50 euro ndërsa fushëveprimi i saj **përfshinë** 1,795.23 km. Kjo kontratë është e ndarë në 14 lote të cilët mbulojnë 7 regjione të ndarë në dy pjesë⁴. Punët që parashihen të kryhen sipas kësaj kontrate ndahen në punë verore (rehabilitimi i gropave, rivendosja e shtresës së re qarkulluese -asfaltbeton, bakinat, dhënia e formave dhe pastrimi i kanaleve drenuese, pastrimi i lëshesave, prerja e barit dhe shkurreve për të improvizuar dukshmërinë, largimin e materialit të eroduar-gurëve dhe rrëshqitjeve të vogla) dhe punë dimërore (mbrojtëset e borës, sinjalizim i trafikut, pastrim i borës, masat për t'iu kundërvu akullit, largimi i gurëve të rënë dhe mbeturinave nga rruga, furnizimi dhe shpërndarja e kripës dhe materialeve gurore, monitorimi i sistemit dhe raportimi për kushtet).⁵

Njoftimi për këtë kontratë⁶ është bërë më 29 shtator 2017 ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte 26 janar 2018⁷. Ky proces i tenderimit është tejzgatur për shkak të ankesave të shumta të OE-ve rreth vendimeve të AK-MI për operatorët e rekomanduar për dhënie të kontratës, e si rrjedhojë kontratat për të gjitha lotet janë nënshkruar vetëm pas **15 muajve** nga data e shpalljes së njoftimit për kontratë.

Në adresë të OSHP-së, lidhur me këtë proces të prokurimit, janë deponuar gjithsej 15 ankesa. Përkundër faktit që vendimet e OSHP-së merren me vonesa të konsiderueshme⁸ dhe kjo është edhe një nga arsytet e zgjatjes së këtij procesi të tenderimit, ajo

1 Ligji nr. 2003/11 për rrugë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120 dhe Ligjin nr. 06/L-068. Neni 8.1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2467>

2 Raporti i KDI-së Rruga tek paratë, <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/54-2016-03-rruga-tek-parate-monitorimi-i-min-se-infrast-alb-isbn.pdf>

3 Njoftimi për kontratë. https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=80215 Prishtina 1 dhe 2, Prizreni 1 dhe 2, Peja 1 dhe 2, Gjakova 1 dhe 2, Ferizaj 1 dhe 2, Gjiilan 1 dhe 2 dhe Mitrovica 1 dhe 2.

4 https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=80215

5 E-Prokurimi, Njoftimi për Kontratë, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=80215

7 Afati për dorëzimin e ofertave i caktuar fillimisht ishte 23 tetor 2017, por u shtye më pas me vendim të OSHP-së për datën 26 janar 2018.

8 Vonesat e OSHP-së arsyetohen me mungesën e stafit në OSHP. Nga takimi me Kryetarin e OSHP-së Blerim Dina më 19.11.2018.

çfarë konsiderohet shqetësuese është që në vendimet e OSHP-së **substancia e pretendimeve ankimore nuk trajtohet**⁹. Në shumicën e vendimeve, OSHP-ja kërkon që AK-të në procesin e rivlerësimit të sqarojnë dhe verifikojë provat të cilat janë objekt i pretendimeve ankimore të OE-ve ankues (gjë të cilën AK-MI nuk e përfillë). Këtë veprim (apo mos veprim) të tyre në OSHP e arsyetojnë me faktin se detyrat e tyre janë të verifikojnë nëse ka apo jo shkelje të ligjit, e jo të hulumtojnë në lidhje me vërtetësinë e ndonjë dokumenti, të bëjnë kalkulime të çmimeve etj¹⁰, veprim ky në kundërshtim me kompetencat e tyre sipas LPP.¹¹ Ajo çfarë është vërejtur në vendimet e OSHP-së është edhe fakti që **rekomandimet e ekspertit shqyrtues nuk merren parasysh**. Në shumicën dërmuese të rasteve vendimi i panelit shqyrtues ka qenë i kundërt me propozimin e ekspertit shqyrtues. Edhe më shqetësues është fakti që vendimet e OSHP-së nuk respektohen nga AK-MI-ja¹², e kjo ka ndikuar që për vendimet e AK-së të deponohen ankesa në OSHP, më shumë se një herë dhe për arsye të njejta.

Nga analizimi i pretendimeve ankimore të OE-ve të eliminuar lidhur me vendimet e AK-MI-së për dhënie të kontratës shihet që pretendimet ankimore të OE-ve të eliminuar, kryesisht, kanë të bëjnë me mospërbushje të kriterëve të DT-së nga operatorët të rekomanduar për kontratë. Pretendimet ankimore më të shpeshta lidhen me kriteret diskriminuese dhe favorizuese në DT, licenca të ndryshme jovalide, dëshmitë e përvojës së punës së inxhinjerëve, mungesa e paisjeve të nevojshme, pastaj metoda joadekuate e noterizimit të listës së paisjeve, çmimie jonormalisht të ulta, çmimet e larta¹³, papërshtatshmëria e OE për shkak të dosjes jo të pastërt penale¹⁴ etj.

Vonesat e shumta në procesin e tenderimit kanë bërë që shumë rrugë regjionale dhe nacionale¹⁵ të mbesin pa mirëmbajtje për një kohë më të gjatë. MI-ja ka deklaruar se në rrugët për të cilat ishte vonuar lidhja e kontratës, është intervenuar vetëm në raste emergjente, por nuk ka sqaruar nëse ka aneks kontrata apo ndonjë marrëveshje me OE-të të caktuar për këto regjione¹⁶. KDI ka marrë përgjigje të ndryshme nga zyrtarët e MI-së lidhur me këtë çështje¹⁷, ndërsa qasje në dokumente që do të dëshmonin ndonjë marrëdhënie kontraktuale për këtë periudhë kohore nuk është dhënë. Më vonë KDI ka mësuar që MI në fund të dhjetorit 2017 dhe fillim të janarit të vitit 2018 ka nënshkruar **kontrata emergjente** me 14 operatorë për 14 lote për periudhën kohore deri më 31 mars 2018. KDI e vlerëson shqetësues faktin që MI për kontratën për mirëmbajtje të rrugëve po bashkëpunon kryesisht me operatorë të njejtë. Ky përfundim vjen nga analizimi i OE-ve fitues qysh nga kontrata e kaluar (2014 - 2017), kontrata emergjente (janar - mars 2018) si dhe kontrata aktuale (2017, 2018, 2019) ku operatorët ekonomik që janë të njejtë¹⁸.

Vonesa në fillimin e procesit të tenderimit, kriteret diskriminuese në DT, mos shqyrtim i kërkesave të OE-ve në adresë të AK-MI-së, vlerësim jo i saktë i ofertave, vonesa në procesin e shqyrtimit të ankesave nga OSHP, mos respektim i vendimeve të OSHP-së nga ana e MI-së etj, janë problemet që e kanë përcjellur këtë proces të prokurimit. Çmime jo normalisht të ulëta, çmime shumë të ndryshme për punë të njejta nga OE të ndryshëm, çmime më të larta për punë më të lehta dhe çmime të ulëta për punë të rënda janë gjetje të KDI-së gjatë analizimit të kontratave të nënshkruara nga MI me 14 OE.

Me qëllim të përmirësimit të praktikave të prokurimit në këtë ministri, KDI rekomandon që fillimisht planifikimi i prokurimit duhet të bëhet me kujdes dhe konform nevojave, procedurat e prokurimit duhet të fillohen sa më herët me qëllim të evitimit të vonesave apo kontratave emergjente të mundshme, ankesat e OE-ve duhet të shqyrtohen nga MI-ja me qëllim të shmangies së vonesave të mundshme në OSHP, e në rastet kur vendimet MI-së gjykohen nga OSHP-ja, këto vendime duhet të respektohen nga MI-ja.

9 Shpesh OSHP nuk jep një verdikt lidhur me një pretendim nëse qëndron apo jo.

10 Takim me Drejtorin e OSHP-së, Z. Blerim Dina më date 19.11.2018.

11 Kompetencat e OSHP-së Neni 105.2. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

12 Raste konkrete të trajtuara në pjesën e ankesave të OE-ve.

13 Pretendimet ankimore të disa operatorëve që janë eliminuar me arsyetimin se nuk kanë qenë oferta me çmim më të lirë, bazohen në atë se në DT vlera e paraqitur është vetëm vlerë indikative.

14 Njëri nga OE i rekomanduar për kontratë me një vendim të mëparshëm të OSHP-së është shpallë i papërgjegjshëm për arsyen se Pronari i këtij operatori është i dënuar për vepra korruptive që sipas LPP Neni 65, janë arsye për shpalljen e operatorit të papërgjegjshëm.

15 Prishtina 1 dhe 2, Mitrovica 1 dhe 2, Gjakova 1, Peja 2, Gjilan 2, Ferizaj 1 dhe 2.

16 Kemi dërguar pyetje dhe kemi kërkuar nga Zyra e prokurimit publik në kuadër të MI-së që të na jep qasje në këto aneks kontrata apo marrëveshje por nuk kemi marrë përgjigje.

17 Në takim me Menaxherin e Zyres së prokurimit publik Z.Nexhat Krasniqi, ai na tha se në regjionet pa mirëmbajtje intervenohet vetëm në raste emergjente dhe këtë intervenim e bëjnë OE-të e regjioneve më të afërta pa ndonjë kompensim, ndërsa në takimin me Z.Skender Gashi, Drejtor i Departamentit për Menaxhim të Rrugëve në MI, na ka thënë se MI ka aneks kontrata me OE performues të rajoneve më të afërta, të cilët intervenojnë në rajonet pa mirëmbajtje.

18 Përveç në Lotin Mitrovica 2 ku OE fitues ka ndryshuar në kontratën aktuale.

HYRJJE

Ministria e Infrastrukturës vazhdon të jetë një nga institucionet me buxhetin më të lartë për investime kapitale¹⁹. Duke qenë se infrastruktura rrugore mbetet një nga fushat më të rëndësishme²⁰, me probleme të shumta²¹ dhe e shumëpërfolur për afëra korruptive²² dhe keq-menaxhime të parasë publike²³, Instituti Demokratik i Kosovës, bazuar edhe në përvojat shtatë-vjeçare të monitorimit të prokurimit publik në këtë institucion ka konsideruar shumë të nevojshme përcjelljen e aktivitetit prokurues në këtë ministri, si një nga proceset kyçe në shpenzimin e parasë publike²⁴. Raportet e mëhershme të monitorimit nga KDI lidhur me prokurimin publik në MI²⁵, kanë shpërfaqur parregullësi të shumta. Në vitin 2016, KDI kishte gjetur se nga kontrata 9.1 milion eurosh për mirëmbajtje të rrugëve nacionale dhe regjionale, ishin "humbur" 1.9 milion euro, dhe kjo, duke eliminuar nga tenderimi operatorin ekonomik (OE) më të lirë, nën pretekstin e papërgjegjshmërisë, dhe duke përzgjedhur OE më të shtrenjtë, të cilët pas inspektimit para fillimit të punëve kishin rezultuar gjithashtu të papërgjegjshëm. Raporte të ndryshme vendore nga shoqëria civile dhe mediat²⁶ pasqyrojnë probleme nga më të ndryshmet për sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve. Një gjë të tillë e thotë edhe Zyra Kombëtare e Auditimit²⁷ ku sipas raportit të tyre disa nga problemet kyçe lidhen me vonesa në iniciimin e procedurave të prokurimit – që kishin shkaktuar zgjatje të afatit të kontratave dhe punë shtesë; bashkimin e mirëmbajtjes verore dhe mirëmbajtjes dimërore në një tender të vetëm – që ka prodhuar kërkesa vështirë të arritshme për OE për t'u kualifikuar, ulje të konkurrencës dhe rrezikim të arritjes së vlerës për para; mospërfundimi i specifikacioneve teknike lidhur me gjerësinë e rrugëve që ka pamundësuar kalkulim të saktë të shpenzimeve për mirëmbajtje të rrugëve; dhënie të kontratave pa publikim të tenderit; mungesë të dokumentimit të raportimit dhe regjistrimit të mirëfilltë të punëve dhe shpenzimeve të realizuara.

Ky punim analizon procedurat e prokurimit lidhur me kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve për vitet 2017, 2018 dhe 2019, për të parë nëse rekomandimet e drejtuara drejt kësaj ministrie, nga KDI, ZKA dhe OJQ-të tjera, janë marrë parasysht, dhe nëse kjo kontratë e re është realizuar konform ligjshmërisë dhe praktikave të mira të prokurimit.

19 Sipas Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Kosovës 2018, 247,572,759 EURO (13% e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës për vitin 2018), <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

20 Kombet e Bashkuara, Konferenca e rukselit 21.05.2001: "Zhvillimi i rrjeteve të infrastrukturës është i lidhur ngushtë me procesin e rritjes ekonomike". Ndër shumë fusha të tjera, ai shqyrton ndikimin e infrastrukturës së transportit në lehtësimin e integritimit ekonomik, rëndësinë e internetit në lehtësimin e tregtisë dhe lidhjen midis infrastrukturës dhe uljes së varfërisë. (e qasur me 26.11.2018 në <https://www.un.org/press/en/2001/dev2328.doc.htm>)

21 Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për MI për vitin 2017, http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_MINF_2017_Shqip.pdf

22 <http://www.arbresh.info/lajmet/ekskluzive-hetime-per-korrupsion-ne-ministrine-e-infrastruktures/>, <http://lajmi.net/zharku-pastron-infrastrukturen-nga-zyrtaret-e-dyshuar-per-korrupsion/>, <https://periskopi.com/denuari-burg-per-korrupsion-behet-drejtor-ne-ministrine-e-infrastruktures-dok/>

23 Raporti Rruga tek Paratë, KDI 2016, I qasshëm në: <http://kdi-kosova.org/publikimet/rruga-tek-parate/>

24 Gjatë vitit 2017, 32% (641,298,561.48 EURO nga 2,001,020,477.00) e Buxhetit të përgjithshëm të Kosovës ishin shpenzuar përmes procedurave të prokurimit publik, Raporti vjetor i KRPP për 2017, i qasshëm në: <https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/2018/06/sh-Raporti%20vjetor%202017%20Komplet.pdf>

25 Raporti Rruga tek Paratë, KDI 2016, I qasshëm në: <http://kdi-kosova.org/publikimet/rruga-tek-parate/>

26 Mbi 31 milionë euro u shpenzuan për mirëmbajtjen e rrugëve, ZERI 19 qershor 2018, i qasshëm në: <https://zeri.info/ekonomia/148989/mbi-31-milione-euro-u-shpenzuan-per-mirembajtjen-e-rrugeve/>, TË VDEËSËSH NË RRUGË, Kosovo2.0, 10 gusht 2017, i qasshëm në: <https://kosovotwopointzero.com/dying-on-the-roads/>

27 <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/07/ProcesiProkurimitPerMirembajtjenRrugeve.212588.pdf>



METODOLOGJIA

Për përpilimin e këtij raporti janë përdorur analiza kuantitative dhe kualitative me qëllim të pasqyrit të një situatë sa më korrekte lidhur me aktivitetin e prokurimit për shërbimet e mirëmbajtjes verore dhe dimërore së rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017/2018/2019 me numër prokurimi: 205-17-4559-2-1-1. Disa nga metodat e shfrytëzuara janë analizimi i të dhënave të qasura përmes e-prokurimit,²⁸ dokumenteve të pranuar nga Ministria e Infrastrukturës²⁹ dhe OSHP³⁰, përmes kërkesave për qasje në dokumente publike³¹, fokus grupit me OE, komunikimi me operatorë ekonomik dhe takimet me përfaqësuesit institucional si OSHP e sidomos nga Ministria e Infrastrukturës.

28 Dokumentet e qasura në e-prokurim janë: njoftimi për kontratë, formularët e përmirësimit të gabimeve, njoftimi për dhënien e kontratës, njoftim për anulim të dhënies.

29 Kontratat e nënshkruara me 11 nga OE, Ofertat e OE.

30 Ankesat e operatorëve, Vendimet e OSHP-së.

31 Kërkesa drejtuar MI-së (05.10.2018), Kërkesa drejtuar OSHP-së (30.10.2018)





TRANSPARENCA E MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS NË PROKURIM PUBLIK

Në kuadër të projektit për monitorimin e prokurimit publik, KDI, më 03 tetor 2018 ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës të përfaqësuar nga Ministri Z. Pal Lekaj. Që të dyja palët përmes këtij memorandum janë zotuar për bashkëpunim, qasje më të lehtë në dokumente publike, shkëmbim të informatave dhe avansim të procesit të prokurimit në përgjithësi.

Qasja në dokumentet e nevojshme në këtë ministri ka qenë sfidë në vete. Kërkesës së KDI-së për qasje në dokumente publike të dërguar më 05 tetor 2018, Ministria e Infrastrukturës nuk i është përgjigjur deri në ditën e fundit të afatit kohor të paraparë me ligj, pas rikujtimit nga KDI. Në këtë ditë, KDI-së i është caktuar një takim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Menaxherin e Prokurimit.

Edhe pse në kërkesën për qasje në dokumente drejtuar kësaj ministrie, KDI ka listuar qartazi të gjitha dokumentet e kërkuara, për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërmjet departamenteve brenda ministrisë, KDI-së i është dashur t'a ri-drejtojë kërkesën në secilin prej departamenteve, gjë që është dashur të koordinohet nga vet departamentet brenda ministrisë, konform Ligjit për qasje në dokumente publike³².

Përkundër zotimit nga të gjithë udhëheqësit e departamenteve përkatëse³³ për dhënie të qasjes në dokumente, KDI ka hasur në pengesa "administrative", të cilat kanë rezultuar me vonesa në sigurimin e dokumenteve. Në departamentet përkatëse të ministrisë, janë dërguar gjithsej shtatë kërkesa për qasje në dokumente publike, prej të cilave MI është përgjigjur në katër, ndërsa qasja e tyre ishte si vijon:

- Zyra e prokurimit, ka ofruar qasje në dokumentet e kërkuara (përveq Planit të prokurimit dhe aneks kontratave).
- Departamenti për Menaxhimin e Rrugëve ka qenë bashkëpunues dhe dokumentet i ka dërguar me kohë.
- Departamenti i Inspektoriatit nuk ka ofruar qasje në dokumentet e kërkuara, me ç' rast KDI e ka pasur të pamundur të bëjë një analizë të përgjegjshmërisë së operatorëve ekonomik, konform kontratave të nënshkruara dhe raporteve të inspektimit të kapaciteteve të OE-ve para fillimit të punëve, e që ishte një nga gjetjet kryesore nga raporti paraprak i KDI-së për këtë Ministri³⁴.

32 Ligji Nr. 03/L-215 për qasjen në dokumente publike, Neni 7.2.

33 Zyra e Prokurimit, Departamenti për menaxhimin e rrugëve, Departamenti i inspektoriatit, Departamenti për financa.

34 Raporti Rruga tek Paratë, KDI 2016, I qassshëm në: <http://kdi-kosova.org/publikimet/rruga-tek-parate/>





- Departamenti i Financave nuk ka ofruar qasje në dokumentet e kërkuara lidhur me kontratën që është trajtuar në këtë raport por ky departament ka ofruar qasje në raporte financiare të kontratës së kaluar.
- Një kërkesë pa përgjigje drejtuar Departamentit për komunikim me publikun (për adresim në departamentin përkatës - të panjohur për KDI-në) lidhur me gjobat e mundshme të shqiptuara për OE-të, për mos përmbushje të obligimeve kontraktuale të mirëmbajtjes nga OE³⁵.

Një element shumë ndihmues gjatë kësaj analize, në krahasim me hulumtimet paraprake, ka qenë funksionalizimi i platformës E-Prokurimi³⁶, e cila ka zvogëluar vonesat e mundshme në pranimin e dokumenteve të nevojshme për analizim³⁷. Megjithatë, qasja në këtë platformë është e reduktuar për publikun dhe qytetarët në përgjithësi, pasi paraprakisht kërkohet regjistrimi si person fizik ose juridik, ndërsa edhe pas regjistrimit personat fizik nuk kanë qasje në të gjitha dokumentet që janë të publikuara në këtë platformë. KDI ka vërejtur se në ueb faqen e e-prokurimit nuk ka asnjë njoftim valid³⁸ për nënshkrim të kontratës³⁹, lidhur me këtë aktivitet tenderimi, ndërkohë që kontratat për implementimin e 14 llojeve veçse janë nënshkruar⁴⁰.

35 Në debatin televiziv "Mirëmbajtja e rrugëve në Kosovë, dhe vonesat në procesin e tenderimit" Emisioni PULS, KTV, 3 dhjetor 2018, ku mes të tjerash, z. Rexhep Kadriu jep premtim publik se me një kërkesë për qasje në dokumente publike mund të sigurojmë informacione nga ministria lidhur me numrin e gjobave që shqiptuara ndaj OE-ve. I qasshëm në: <https://www.youtube.com/watch?v=uKDhCK2te7k>.

36 <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx>

37 Dokumentet e siguruar nga e-prokurimi: Dosja e Tenderit, Njoftim për kontratë, Formular për korrigjim të gabimeve, Njoftime për dhënie të kontratës, Njoftim për anulim të aktivitetit

38 Një njoftim për nënshkrim të kontratës është publikuar më datë 20 dhjetor 2018 por është i zbrazët, i qasshëm në: http://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=314079

39 https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=239447 qasur më 13.12.2018.

40 Konkluzion i datës:30 nëntor 2018



|||||

Regjionet	Prizreni 1	Prizreni 2	Mitrovica 1	Mitrovica 2	Gjilani 1	Gjilani 2	Gjithsej
Km(dimërore)	149.46	106.58	157.28	112.77	145.14	111.58	1,953.17
Km (verore)	155.00	101.86	150.12	116.57	123.58	111.58	1,795.23
Vlera e parashikuar	1,192,231.88	1,041,227.28	1,330,298.96	63,151.99	1,378,716.18	1,095,095.55	17,231,050.50

EDHE PSE KJO KONTRATË është paraqitur si Kontratë kornizë me disa operatorë, me mini konkurrence, për secilin lot është përzgjedhur nga një OE fitues dhe procesi i mini konkurrencës nuk është zbatuar.

Sipas njoftimit për kontratë Kontrata për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe rajonale 2017, 2018 dhe 2019 fillimisht ishte kontratë publike kornizë me disa operatorë, **me mini-konkurrencë** dhe për periudhën kohore prej 36 muajsh⁴². Vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte 17,178,672.10 ndërsa fushëveprimi i saj përfshinë 1,795.23 km.

Kjo kontratë është e ndarë në 14 lote, të cilët mbulojnë 7 regjione të ndarë në nga dy pjesë⁴³ ndërsa një kompani nuk mund të fitonte më shumë se një lot.

NË NJOFTIMIN PËR KONTRATË nuk figuronte ndarja në pjesë e aktivitetit, për dallim nga Dosja e Tenderit (DT) ku figuronte që ky aktivitet ishte i ndarë në 14 pjesë. Kjo mospërputhje e të dhënave ndërmjet DT dhe Njoftimit për kontratë kishte krijuar paqartësi për ofertuesit e mundshëm, por e njehta nuk është përmirësuar nga AK-MI pasi që në të gjithë formularët e publikuar mund të shihet se nuk figuron ndarja në pjesë.

Faza e tenderimit lidhur me kontratën tre vjeçare për mirëmbajtjen e rrugëve nacionale dhe regjionale është përcjellë me anketa të shumta të OE-ve jo fitues që si rrjedhojë kanë ndikuar në zgjatjen e këtij procesi për 15 muaj nga data e fillimit. Duke marrë parasysh rëndësinë e mirëmbajtjes së rrugëve, sidomos në stinën e dimrit, dhe pasojat që qytetarët mund t'i bartin nga mungesa e saj, MI-ja është dashur t'i kushtoj më tepër rëndësi procesit të tenderimit për këtë kontratë, me qëllim të evitimit të vonesave, të cilat në praktikë përkthehen në mosrregullim të gropave në rrugë, mos pastrim të borës, mospastrim të gurëve të rënë në rrugë etj, e që të gjitha këto paraqesin rrezik të lartë në komunikacion. Madje vonesat e MI-së në procedurat e prokurimit për kontratën e mirëmbajtjes janë e gjetur edhe e Raportit të ZKA-së.⁴⁴

42 https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=80215

43 Prishtina 1 dhe 2, Prizreni 1 dhe 2, Peja 1 dhe 2, Gjakova 1 dhe 2, Ferizaj 1 dhe 2, Gjilan 1 dhe 2 dhe Mitrovica 1 dhe 2.

44 <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/07/ProcesiProkurimitPerMirmbajtjenRrugeve.212588.pdf>

|||||



Procedura emergjente pa publikim të njoftimit për kontratë

Sipas një Njoftimi për nënshkrim të kontratës të datës 16 shkurt 2018, Ministria e Infrastrukturës ka nënshkruar Kontratë për **Mirëmbajtje dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale për sezonin dimëror 2017/2018**, me 14 OE, me afat të përfundimit deri më 31 mars 2018. Për këtë tender MI ka përdorur procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Vlera e parashikuar e kësaj kontrate parashihej prej 4,700,000 euro. Operatorët me të cilët MI ka nënshkruar kontrata janë operatorët që ishin performues të kontratës për mirëmbajtje për vitet 2014-2017. MI ka nënshkruar kontrata me 14 OE-të në fund të dhjetorit 2017 dhe fillim janar 2018. Njoftimi për dhënien e kontratës dhe njoftimi për nënshkrimin e kësaj kontrate nuk janë publikuar në platformën e-prokurimi përkundër obligimit ligjor, ndërkohë që njoftimi për nënshkrim të kontratës është publikuar në web faqen e KRPP-së dhe mund të gjindet tek njoftimet e arkivuara.

Procedura e vlerësimit / ankesat

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë më 26 mars 2018⁴⁸. Edhe në këtë fazë është evidentuar vonesë dy mujore nga AK-MI në marrjen e vendimit pasi që hapja e ofertave është bërë më 26 janar 2018⁴⁹ dmth nga hapja e ofertave deri te njoftimi për dhënie AK i janë dashur dy muaj. Për vendimin e AK-MI lidhur me OE-të e rekomanduara për kontratë, gjashtë operatorë ngritën ankesa për nëntë lote, në OSHP. Pretendimet ankimore të OE-ve ankuese ishin se në vendimin e saj se AK-MI-ja kishte shkelur nenet e LPP-së si në vijim: 1; 1 (par 36); 6; 7; 7 (par 1,2,3); 8; 9; 10; 11; 13; 27; 28; 52; 54; 59; 56; 60; 61; 65 (par 3,4); 66; 67; 68; 69; 70; 72.

Pas shqyrtimit dhe vendimit të OSHP-së⁵⁰ (për të gjitha ankesat e OE-ve ankues), u vërtetua dhënia e kontratave për shtatë lote, ndërkohë që shtatë lote u dërguan në rivlerësim. Vlen të theksohet se vendimi i OSHP-së është marrë më 05 qershor 2018 ndërsa ankesat e OE janë bërë nga data 10 deri 13 prill 2018, dmth rreth dy muaj i u janë dashur OSHP-së që të marr këtë vendim.

NGA HAPJA E OFERTAVE deri në njoftimi për kontratë AK u vonua dy muaj.

Lotet për të cilat u lidh kontratë	Lotet në rivlerësim
Prizreni 1 (05.04.2018)	Prishtina 2
Prizreni 2 (05.04.2018)	Gjakova 1
Gjakova 2 (05.04.2018)	Peja 2
Peja 1 (05.04.2018)	Gjilani 2
Gjilani 1 (05.04.2018)	Ferizaj 1
Prishtina 1 (06.06.2018)	Mitrovica 1
Ferizaj 2 (07.06.2018)	Mitrovica 2

Njoftimi për dhënie të kontratës i dyti me radhë, është bërë më 03 korrik 2018⁵¹.

48 E-prokurimi, Njoftimi për dhënie të kontratës, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=131565

49 E-prokurimi, Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ku është e përcaktuar që hapja e tendeerëve do të bëhet më 26.01.2018 nga ora 14:00:00, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=101517

50 OSHP, Vendimet, <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/131-132-138-140-143-148-18-vend.pdf>

51 E-prokurimi, Njoftimi për dhënie të kontratës, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=196919

Edhe pas procesit të rivlerësimit AK-MI-ja kishte rekomanduar për kontratë të njejtit OE përveç për Lot Mitrovica 2, ku kishte ndryshuar vendimin.

Edhe për këtë vendim të AK-MI-së ishin dorëzuar gjithsej pesë ankesa prej OE-ve, në adresë të OSHP-së. Pretendimet ankimore të OE-ve ankuese ishin se në vendimin e saj AK-MI kishte shkelur nenet e LPP-së si në vijim: 1; 6; 7; 7 (par 1,2,3); 10; 38; 52; 54; 59 (par 1,2,4); 56; 60; 68; 69; 72.

Pas shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të OSHP-së⁵² (vendim i përbashkët për të gjitha ankesat), u vërtetua dhënia për katër kontrata ndërsa tri lote u kthyen sërish në rivlerësim. Ankesat janë bërë ndërmjet datave 11-19 korrik 2018 ndërsa vendimi i OSHP-së i marrur më 31 gusht 2018 (gjashtë javë kohë i'u desh OSHP-së për të marrë vendimin).

Lotet për të cilat u lidh kontratë	Lotet në rivlerësim
Mitrovica 1 (04.09.2018)	Gjakova 2
Mitrovica 2 (12.07.2018)	Pejë 1
Gjilan 2 (04.09.2018)	Ferizaj 2
Prishtina 2 (12.07.2018)	

Njoftimi për dhënie të kontratës i treti me radhë është bërë më 13 shtator 2018⁵³. Ishte kjo hera e tretë që vendosej për tri lote që kishin mbeur pa u dhënë. Edhe pse OSHP-ja kishte vendosur në favor të OE-ve ankues prapë AK-MI mori vendimin e njejtë dhe rekomandoi për kontratë OE-të e njejtë. Edhe për këtë njoftim të AK-MI pati tri ankesa të OE-ve në OSHP.

Pretendimet ankimore të OE-ve ankuese ishin se në vendimin e saj AK-MI kishte shkelur nenet e LPP-së si në vijim: 1; 6; 7; 7 (par 1,2,3); 38; 59 (par1, 2,4); 56; 59; 60; 65; 69; 72; 105.

Ankesat u bënë ndërmjet datave 27 shtator dhe 01 tetor ndërsa vendimi i OSHP-së u nxorr më 12 nëntor 2018⁵⁴. Me këtë Vendim të OSHP-së u vërtetua dhënia për dy lote pasi që kësaj radhe AK-MI, kishte bërë disa llogaritje (gjë e cila kishte mundur të bëhet pas ankesës së parë nga përfaqësuesi i AK-MI-së apo nga ekspertët e OSHP-së) dhe sjelli dëshmi ofertat e OE-ve ankues ishin më të shtrenjta (që kishte qenë arsyeja e eliminimit të tyre) se ofertat e OE-ve të rekomanduara për kontratë. Edhe kësaj radhe, me vendim të OSHP-së, njëri nga lotet u kthye prapë në rivlerësim.

Lotet për të cilat u nënshkrua kontratë	Lotet e kthyera në rivlerësim
Ferizaj 1 (29.11.2018)	Peja 2
Gjakova 1 (29.11.2018)	

52 OSHP, Vendimet, <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/337-343-349-354-357-18v6ndim.pdf>

53 E-prokurimi, Njoftimi për dhënie të kontratës, https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=239465

54 OSHP, Vendimet, <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/518%20520%20531-18vend.pdf>





Njoftimi për dhënien e kontratës i katërti me radhë, nuk është publikuar në platformën e-prokurimi por është publikuar vendimi i AK-MI-së i datës 22 nëntor 2018 lidhur me operatorin e rekomanduar për lotin Peja 2. Kjo ishte hera e katërt që AK-MI-ja vendoste për këtë lot. MI-ja kësaj radhe rekomandon për kontratë OE-në që sipas OSHP-së është i vetmi i operator i përgjegjshëm për këtë lot ndërsa eliminon si të papërgjegjshëm⁵⁵ operatorin që në tri rastet e mëhershme kishte rekomanduar për kontratë.

Por edhe ky vendim i MI-së u dërgua në OSHP nga tashmë OE-ve i eliminuar por kjo ankesë u hodh poshtë nga OSHP-ja⁵⁶, duke u validuar kështu vendimi i AK-MI-së, me çfarë ky proces i prokurimit mori fund.

Loti për të cilin u nënshkrua kontratë

Peja 2

ME KËTË VENDIM të OSHP-së të datës 13 dhjetor 2018, merr fund i tërë procesi i tenderimit të kësaj Kontrate kornizë që kishte filluar më 29 shtator 2017.



⁵⁵ Sipas nenit 65 paragrafi 3 pika 4 e LPP

⁵⁶ Vendimi i OSHP-së. <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/728-18vend.pdf>



Që nga njoftimi fillestar për kontratë e deri tek njoftimi i fundit për dhënie të kontratës, janë depozituar gjithsej 15 ankesa nga OE-të e pasuksesshëm në këtë proces drejtuar OSHP-së. Tabela e mëposhtme paraqet numrin e ankesave të deponuara në OSHP, për secilin prej 14 loteve.



57 Janë gjithsej 15 ankesa. Por në disa raste operatori i njejtë brenda një ankeses është ankuar për më shumë lote andaj numri i ankesave për lote ndryshon nga numri i ankesave të OE-ve.

VLERËSIMI I KONTRATAVE

Komisioni për vlerësimin e ofertave filloi punën më 09.03.2018, ku pas vlerësimit dhe krahasimit të ofertave konstatoi se kishin ofertuar gjithsej 31 OE pjesëmarrës për 14 lote. Komisioni vlerësoi të përgjegjshëm 19 OE kurse 12 prej tyre u diskualifikuan si të papërgjegjshëm.

Ky komision rekomandoi për kontratë 14 operatorë nga operatorët e përgjegjshëm. Ndërsa i diskualifikoi pesë nga operatorët e përgjegjshëm për shkak të çmimit më të lartë.

Metoda e vlerësimit të ofertave është bërë sipas çmimeve për njësi për sasinë indikative një.

Regjioni Prishtina 1

Ministria e Infrastrukturës ka hyrë në marrëdhënje kontraktuale me Operatorin Arbotec më **06.06.2018**. Ky operator ka marrë përsipër punët e Mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale në Regjionin Prishtina 1. Çmimi total i punëve është 280.53 euro për njësi, ndërsa vlera e kësaj kontrate është 1,025,935.58 euro⁵⁸.

Për këtë lot kanë aplikuar katër OE. Dy nga operatorët jo fitues të këtij loti janë fitues të loteve tjera, kurse një OE është shpallë i papërgjegjshëm. **Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme oferta e OE fitues** ishte oferta me çmimin më të lirë.

Tabela 1- Krahasimi i ofertave financiare në regjionin Prishtina 1

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi
Arbotec	Performues i kontratës	280.53
ViaEgnatia&Millenium&Zhubi Group	OE i papërgjegjshëm	290.87
Damastion	Fitues në një regjion tjetër	341.34
Integral	Fitues në një regjion tjetër	399.75

Për vendimin e AK-MI-së është ankuar në OSHP operatori Via & Egnatia & Millenium Construction, që sipas Raportit të vlerësimit të hapjes së tenderëve, është shpallë i papërgjegjshëm me arsyen se listën e paisjeve nuk e kanë sjellë sipas kërkesave të DT. Pretendimi ankimor i këtij operatori ishte se ata kanë sjellë listën e pajisjeve siç ishte kërkuar dhe se ishin eliminuar pa arsye.

OSHP-ja ka vërtetuar pretendimet ankimore të OE, por prapë vendimi i OSHP⁵⁹-së ka qenë në favor të AK-MI-së pasi që ky operator ka ofertuar me çmim më të lartë se OE fitues.

⁵⁸ Vlera e kontratës është llogaritur duke shumëzuar çmimet e ofertuara për njësi nga operatori me sasinë indikative të njësisve të paraqitur në DT nga AK.

⁵⁹ Vendimi i OSHP-së me nr.131/132/138/140/143/148/18. <https://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>.

Nëse e pjestojmë vlerën totale të kontratës me totalin për njësi atëherë do të fitojmë $1,025,935.58/280.53=3,657.13$ njësi. Atëherë dallimi ndërmjet ofertave do të ishte si në tabelë.

Tabela 2- Krahasimi i ofertave - Regjioni Prishtina 1

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Arbotec	Performues kontratës	280.53	3,657.13	1,025,935.58
ViaEgnati&Milenium&Zhubi Group	OE i papërgjegjshëm	290.87	3,657.13	1,063,749.40
Damastion	Fitues në një regjion tjetër	341.34	3,657.13	1,248,324.75
Integral	Fitues në një regjion tjetër	399.75	3,657.13	1,461,937.71

Regjioni Prishtina 2

Për regjionin Prishtina 2, MI-ja ka nënshkruar kontratë me OE Integral më **12.07.2018** me çmim të punëve prej 444.72 euro për njësi. Totali i kësaj kontrate është 993,741.61 euro.

Për këtë lot kanë ofertuar tetë OE. Pesë nga OE-të që kanë ofertuar për këtë regjion janë shpallur fitues për regjione tjera, një është eliminuar për shkak të çmimit të lartë, ndërsa një operator është konsideruar i papërgjegjshëm.

Sa i përket çmimit të ofruar, oferta e OE fitues ka qenë oferta e tretë më e lirë, por operatorët me oferta më të lira janë fitues të kontratave në lote tjera.

Tabela 3- Krahasimi i ofertave financiare në regjionin Prishtina 2

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi
Integral	OE performues	444.72
RSM	Fitues në një regjion tjetër	134.23
Arbotec	Fitues në një regjion tjetër	277.57
2A & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	748.90
Conex Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	748.90
Alfa.I shpk&Vllaznia&Urban&Baageri	Tenderues i pasuksesshëm	787.43
Tali	Tenderues i pasuksesshëm	1,085.86
Zahiri & Beni	OE i papërgjegjshëm	2,443.53

Për vendimin e AK-MI-së lidhur me këtë lot në OSHP ka dorëzuar ankesë OE "Alfa.I shpk & Vllaznia & Urban & Bageri". Ky operator është eliminuar për shkak se nuk kanë qenë oferta me çmimin më të ulët. Pretendimet ankimore të këtij operatori kanë qenë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbushur kërkesat teknike dhe profesionale, konkretisht, për inxhinierin e gjeodezisë që ka kryer studimet jashtë vendit, ky OE ka sjellë referenca të punëve të kryera në vitet 2010 dhe 2011 ndërkohë

që nostrifikimi i diplomës së këtij personi ka datë 27 janar 2015. Një praktikë e tillë bie ndesh me Urdhërin Administrativ të MASHT neni 3.1 ku thuhet se të gjitha diplomat të fituara jashtë vendit me qëllim të punësimit duhet tu nënshtrohen procedurave të njohjes-barasvlerës në MASHT. Rrjedhimisht ky inxhinjer ose i ka falsifikuar të dhënat për përvojën ose e ka ushtruar profesionin pa të drejtë. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë sipas operatorit ankues nuk ka plotësuar as kriteret mbi mundësitë teknike pasi kishte mungesë të paisjeve.

Vendimi i OSHP-së⁶⁰ është në favor të OE ankues dhe lënda u kthye në rivlerësim. Edhe në procesin e rivlerësimit AK-MI prapë ka përzgjedhur operatorin e njejtë për shpërblim me kontratë, dhe ky vendim u validua nga OSHP-ja pas ankeses së dytë të operatorit të njejtë ankues.

Nëse e pjestojmë vlerën totale të kontratës me çmimin për njësi atëherë do të fitojmë $993,741.61/444.72=2,234.53$ njësi. Në bazë të kësaj mund ti krahasojmë ofertat.

PËR RASTIN e njejtë e pretendimet e njejtja ankimore OSHP merr vendime të ndryshme.

Tabela 4- Krahasimi i ofertave - Regjioni Prishtina 2

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Integral	OE performues	444.72	2,234.53	993,741.61
RSM	Fitues në një regjion tjetër	134.23	2,234.53	299,940.96
Arbotec	Fitues në një regjion tjetër	277.57	2,234.53	620,238.49
2A & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	748.90	2,234.53	1,673,439.51
Conec Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	748.90	2,234.53	1,673,439.51
Alfa.I shpk&Vllaznia&Urban&Baageri	Tenderues i pasuksesshëm	787.43	2,234.53	1,759,535.95
Tali	Tenderues i pasuksesshëm	1,085.86	2,234.53	2,426,386.74
Zahiri&Beni	OE i papërgjegjshëm	2,443.53	2,234.53	5,460,141.09

Regjioni Prizreni 1

MI, më datë **05.04.2018** ka nënshkruar kontratë me OE "Famis Co HC" sh.a për regjionin Prizreni 1, në vlerën për njësi prej 1,101.18 euro. Çmimi total i kontratës është 944,889.00 euro.

Për këtë regjion kanë ofertuar katër OE. OE Alko Impex ka qenë ofertues me çmim më të lirë, por ky OE është përzgjedhur fitues në një tjetër regjion, ndërsa dy ofertuesit tjerë kishin çmime më të larta.

Lidhur me dhënjen e këtij loti nuk ka pasur ankesa.

⁶⁰ Vendimi i OSHP-së me nr.131/132/138/140/143/148/18. <https://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>.

|||||

Tabela 5- Krahasimi i ofertave financiare - Regjioni Prizreni 1

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi
Famis Co HC	OE performues	1,101.18
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	308.18
Drini Company	Fitues në një regjion tjetër	3,149.81
Victoria Invest International	Fitues në një regjion tjetër	5,251.09

Nëse e pjestojmë vlerën totale të kontratës me totalin për njësi atëherë do të fitojmë $944,889.00/1,101.1=858.13$ njësi. Në bazë të kësaj mund ti krahasojmë ofertat.

Tabela 6- Krahasimi i ofertave - Regjioni Prizreni 1

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikativeve e kontratës
Famis Co HC	OE performues	1,101.18	858.13	944,889.00
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	308.18	858.13	264,458.50
Drini Company	Fitues në një regjion tjetër	3,149.81	858.13	2,702,946.45
Victoria Invest International	Fitues në një regjion tjetër	5,251.09	858.13	4,506,117.86

Regjioni Prizreni 2

Për regjionin e Prizrenit 2, MI ka lidhë kontratë me OE Drini Company. Kontrata është nënshkruar më 05.04.2018 me çmim 195.21 euro për njësi. Çmimi total i kontratës është 726,427.40 euro.

Për këtë regjion kanë ofertuar tre OE⁶¹. Oferta e OE fitues ishte më e lira, ndërsa dy operatorët e pa suksesshëm në këtë regjion janë fitues të loteve tjera. Sa i përket dhënjes së kontratës për këtë regjion nuk ka pas ankesa nga ndonjë OE.

Tabela 7- Krahasimi i ofertave financiare - Regjioni Prizreni 2

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi
Drini Company	OE performues	195.21
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	307.12
Famis Co	Fitues në një regjion tjetër	2,532.64

Nëse e pjestojmë vlerën totale të kontratës me totalin për njësi atëherë do të fitojmë $726,427.40/195.21=3,721.26$ njësi. Në bazë të kësaj mund ti krahasojmë ofertat.

61 Në raport te hapjes se tendereve nuk figuron oferta e Drinit

|||||

|||||

Tabela 8- Krahasimi i ofertave - Regjioni Prizreni 2

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Drini Company	OE performues	195.21	3,721.26	726,427.40
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	307.12	3,721.26	1,142,873.37
Famis Co	Fitues në një regjion tjetër	2,532.64	3,721.26	9,424,611.92

Regjioni Ferizaj 1

MI ka nënshkruar kontratë me Euro Kos & Via, më 29 nëntor 2018 me çmim për njësi prej 476.64 euro. Vlera totale e kontratës është 766,326.85 euro. Përfundimisht për lotin Ferizaj 1 është vendosur më 12 nëntor 2018, kur me vendim të OSHP-së u vërtetua dhënia e e kontratës për operatorin e rekomanduar nga AK-MI. Ky lot ishte dërguar dy herë në rivlerësim ndërsa vendimi i AK-MI-së është ankimuar tri herë radhazi në OSHP.

Kundër vendimit të AK-MI-së për operatorin e rekomanduar për këtë regjion, ankesë në OSHP kishte dorëzuar OE Eskavatori. Ky operator fillimisht ishte shpallur i papërgjegjshëm me arsyetimin për mungesë të dëshmive për përvojën në një kontratë në vlerë prej 500,000 euro në fushën e mirëmbajtjes së rrugëve. Pas kërkesës për rishqyrtim AK-MI e kishte cilësuar si të përgjegjshëm por prapë, i njëjti ishte eliminuar për çmim më të lartë se operatori fitues.

Pretendimet ankimore të këtij operatori janë se OE i rekomanduar për kontratë nga AK-MI, nuk i plotëson kushtet tekniko profesionale pasi që: (a) i mungon dëshmia nga Agjencia për Miniera dhe Minerale **për gurëthyes të licencuar**, (b) emrat e inxhinierëve të paraqitur si punëtorë nga ky OE nuk figurojnë në listën e punëtorëve të deklaruar në **ATK** që dmth që ata nuk janë punëtorë të rregullt të asaj kompanie dhe (c) nuk plotëson as kriterin e paisjeve të kërkuara. Ky lot është kthyer dy herë radhazi në rivlerësim nga OSHP-ja, ku kërkohej që AK-MI t'i sqarojë nëse dëshmitë e sjella nga OE janë valide. Pas dy proceseve të rivlerësimit, vendimi i tretë i AK-MI-së edhe pse ishte i njëjt, u vërtetua nga OSHP-ja dhe OE ankues u eliminua për shkak të çmimit më të lartë.

Tabela 9- Krahasimi i ofertave financiare- Regjioni Ferizaj 1

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi njësi
Eurokos & Via	Operatori i performues	476.64
RSM	Fitues në një regjion tjetër	114.54
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	349.78
2A Group & @T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	731.02
Conec Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	731.02
Eskavatori & Best Company	OE i papërgjegjshëm	1,341.83
Papenburg & Adriani	OE i papërgjegjshëm	1,588.30
Benita Company & Bes Group & Victory	OE i papërgjegjshëm	14,930.36

Nëse e pjestojmë vlerën total të kontratës me totalin për njësi atëherë do të fitojmë $766,326.85/476.64 = 1,607.57$ njësi. Në bazë të kësaj mund ti krahasojmë ofertat.

|||||

|||||

Tabela 12- Krahasimi i ofertave - Regjioni Ferizaj 2

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Damastion	Operatori performues	312.90	2,365.30	740,103.90
RSM	Fitues në një regjion tjetër	83.85	2,365.30	198,330.40
Benita Company&Bes Group& Victory	OE i papërgjegjshëm	303.08	2,365.30	761,875.12
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	308.43	2,365.30	131,433.73
Jaha	Fitues në një regjion tjetër	426.12	2,365.30	1,007,901.63
Tali	Fitues në një regjion tjetër	689.73	2,365.30	1,631,418.36
2A Group & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	882.71	2,365.30	2,087,873.96
Conec Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	882.71	2,365.30	2,087,873.96
Zuka comerc&Haziri shpk	Tenderues i papërgjegjshëm	982.90	2,365.30	2,324,853.37
Eskavatori&Best Company	Tenderues i pasuksesshëm	1,341.80	2,365.30	3,173,759.54
Papenburg&Adriani	Tenderues i papërgjegjshëm	1,778.93	2,365.30	4,207,703.12

Regjioni Gjilani 1

MI-ja ka lidhë kontratë me OE Tali, më 05 prill 2018 me një çmim të dhënë për njësi prej 498.97 euro. Vlera totale e kontratës është 1,151,582.75 euro.

Për këtë regjion kanë ofertuar tre OE. OE i përzgjedhur ka qenë oferta më e lirë, ndërsa dy operatorët tjerë janë fitues të loteve tjera.

Tabela 13- Krahasimi i ofertave financiare - Regjioni Gjilan 1

Operatorët ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi
Tali ⁶²	Performues i kontratës	498.97
Jaha	Fitues në një regjion tjetër	540.07
Integral	Fitues në një regjion tjetër	503.88

Nëse e pjestojmë totalin e kontratës me çmimin për njësi atëherë fitojmë $1,151,582.75/498.97=303.79$ njësi. Në tabelën e mëposhtme do ti krahasojmë ofertat.

⁶² Nuk figuron në raportin e hapjes së tenderëve

|||||

|||||

Tabela 14- Krahasimi i ofertave - Regjioni Gjilan 1

Operatorët ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Tali	Performues i kontratës	498.97	303.79	1,151,582.75
Jaha	Fitues në një regjion tjetër	540.07	303.79	153,131.42
Integral	Fitues në një regjion tjetër	503.88	303.79	153,073,70

Regjioni Gjilani 2

MI ka nënshkruar kontratë me OE Jaha për regjionin Gjilani 2, më 04 shtator 2018 me çmim për njësi pej 377.53 euro. Vlera totale e kontratës është 844,251.90. Për këtë lot kishin ofertuar tetë OE. Një nga ofertuesit ishte më i lirë se Oe i rekomanduar për kontratë por që ky OE ishte i papërgjegjshëm.

Tabela 15- Krahasimi i ofertave financiare - Regjioni Gjilan 2

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi
Jaha	Performues i kontratës	377.53
Via Egnatia&Milenium&Zhubi Group	OE i papërgjegjshëm	338.21
2A Group & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	762.06
Conec Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	762.06
Zuka comerc&Haziri shpk	OE i papërgjegjshëm	924.98
Tali	Fitues në një regjion tjetër	983.46
Papenburg&Adriani	OE i papërgjegjshëm	1,365.85
Bejta Comerc	OE i papërgjegjshëm	2,075.77

Kundër vendimit të AK-MI-së për OE-në e rekomanduar për kontratë, pranë OSHP-së ishte dorëzuar një ankesë. Pretendim ankimor i OE ankues Via Egnati&Milenium&Zhubi Group ishte që oferta e tyre ishte më e lirë se e operatorit të rekomanduar për kontratë. Pretendimet e këtij operatori u vërtetuan nga OSHP-ja dhe ky lot u dërgua në rivlerësim. Edhe pas procesit të rivlerësimit ky operator nuk u përzgjedh fitues dhe u eliminu për arsye se kishte sjellë referencë jo-valide për Menaxherin e Projektit dhe i njejt nuk figuronte si punëtor i asaj kompanie në listat e punëtorëve të deklaruar në ATK. Ky vendim i AK-MI-së u vërtetua edhe nga OSHP-ja pas ankesës nga operatori i eliminuar.

Nëse pjesëtojmë 844,251.90 me 377.53 atëher fitojmë gjithsej 2,236.25 njësi. Sipas kësaj mund t'i krahasojmë ofertat.

|||||

|||||

Tabela 16- Krahasimi i ofertave- Regjioni Gjilan 2

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Jaha	Performues i kontratës	377.53	2,236.25	844,251.90
Via Egnatia&Mileni-um&Zhubi Group	OE i papërgjegjshëm	338.21	2,236.25	756,322.11
2A Group & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	762.06	2,236.25	1,704,156.67
Conec Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	762.06	2,236.25	1,704,156.67
Zuka comerc&Haziri shpk	OE i papërgjegjshëm	924.98	2,236.25	2,068,486.52
Tali	Fitues në një regjion tjetër	983.46	2,236.25	2,199,262.42
Papenburg&Adriani	OE i papërgjegjshëm	1,365.85	2,236.25	2,068,486.52
Bejta Comerc	OE i papërgjegjshëm	2,075.77	2,236.25	4,641,940.66

Regjioni Mitrovica 1

MI ka nënshkruar kontratë me operatorin ekonomik Alko Impex, për regjionin Mitrovica 1, më 04.09.2018 me çmim për njësi prej 287.13 euro. Vlera totale e kontratës është 1,049,214.92 euro. Për këtë lot, ofertuan gjithsej tetë operator. Oferta fituese për këtë regjion nuk ishte më e lira, por u përzgjedh fitues pasi që OE-të me ofertë më të lirë ishte i papërgjegjshëm. Katër nga operatorët ofertues ishin fitues në lote tjera të këtij tenderi kurse tre tjerë ishin cilësuar si operatorë të papërgjegjshëm.

Tabela 17- Krahasimi i ofertave financiare- Regjioni Mitrovica 1

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi
Alko Impex	Performues i kontratës	287.13
Via Egnati&Milenum&Zhubi Group	OE i papërgjegjshëm	278.79
Benita Company&Bes Group& Victory	OE i papërgjegjshëm	303.08
2A Group & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	721.11
Conec Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	721.11
Alfa.I shpk&Vllaznia&Urban&Bageri	Tenderues i pasuksesshëm	810.41
Tali	Fitues në një regjion tjetër	1,069.12
Shkoza 07& Marsi	OE i papërgjegjshëm	2,643.65

Lidhur me vendimin e AK-MI-së për këtë lot, në OSHP dërgoi ankesë OE Via Egnati & Milenum & Zhubi Group me pretendimin ankimor që ka ofertë më të lirë se OE i rekomanduar për kontratë. Ky pretendim u gjet i sakt nga OSHP-ja dhe loti u kthye në rivlerësim. Edhe pas rivlerësimit, vendimi i AK-MI-së ishte i njëjtë dhe ky OE u eliminua me arsyen se kishte sjellë referencë

|||||

jo-valide për Menaxherin e Projektit dhe i njëjti nuk figuronte si punëtor i asaj kompanie në listat e punëtorëve të deklaruar në ATK. Vendimi dytë i AK-MI-së u vërtetua edhe nga OSHP-ja.

Ankesë në OSHP për këtë lot kishte deponuar edhe OE Alfa.I & Vllaznia Ndërtim I.S &Urban & Bageri. Pretendimi ankimor i tyre ka të bëjë me mospërbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale si dhe mungesë në listën e pasijeve, nga OE i rekomanduar. Sipas tyre udhëheqësi i punishtes të OE të rekomanduar nostrifikimin e diplomave e ka të datës më të vonshme se sa dëshmitë që i ka se ka kryer punimet. OSHP-ja vërteton pretendimet e këtij operatori dhe e dërgon këtë lot në rivlerësim. Edhe pas rivlerësimit vendimi i AK-MI-së është i njëjtë dhe OE ankues Alfa.I & Vllaznia Ndërtim I.S &Urban & Bageri eliminohet për shkak të çmimit më të lartë. OE Alfa.I & Vllaznia Ndërtim I.S &Urban & Bageri ankohet prapë në OSHP, por kësaj radhe OSHP-ja vërteton vendimin e AK-MI-së.

Nëse pjesëtojmë $1,049,214.92/287.13=3,654.14$ njësi. Sipas kësaj mund ti krahasojmë ofertat.

Tabela 18- Krahasimi i ofertave- Regjioni Mitrovica 1

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Alko Impex	Performues i kontratës	287.13	3,654.14	1,049,214.92
Via Egnati&Milenium&Zhubi Group	OE i papërgjegjshëm	278.79	3,654.14	1,018,737.69
Benita Company&Bes Group& Victory	OE i papërgjegjshëm	303.08	3,654.14	1,107,496.75
2A Group & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	721.11	3,654.14	2,635,036.89
Conec Group & El Bau	Tenderues i pasuksesshëm	721.11	3,654.14	2,635,036.89
Alfa.I shpk&Vllaznia&Urban&Baageri	Tenderues i pasuksesshëm	810.41	3,654.14	530,121.59
Tali	Fitues në një regjion tjetër	1,069.12	3,654.14	3,906,714.15
Shkoza 07& Marsi	OE i papërgjegjshëm	2,643.65	3,654.14	9,660,267.21

Regjioni Mitrovica 2

MI-ja ka nënshkruar kontratë me OE RAD & ABC & Trans Company më 12.07.2018 me çmim për njësi prej 1,095.21 euro. Vlera totale e kësaj kontrate është 760,654.00 euro.

Për këtë lot kanë ofertuar pesë operatorë. Tre nga OE-të ofertuese kanë ofruar çmim më të lirë se OE i përzgjedhur për kontratë.

Vlen të ceket se për këtë lot fillimisht AK-MI kishte përzgjedhur si operator të suksesshëm OE "2A & 2T & Jubica" por pas kthimit të lëndës në rivlerësim ky OE ishte shpallur i papërgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kushtet teknike të kërkuara, ndërsa u shpërblye me kontratë operatori ABC & RAD.

Për këtë lot ankesë në OSHP kishte drejtuar OE Jasen i cili ishte eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar formularin (pjesa c), por edhe OSHP kishte vërtetuar arsyen e eliminimit të këtij operatori.

|||||

Tabela 19- Krahasimi i ofertave financiare- Regjioni Mitrovica 2

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi
ABC & RAD	Operatori performues	1,095.21
Jasen	OE i papërgjegjshëm	278.94
2A & 2T & Jubica	OE i papërgjegjshëm	307.17
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	309.36
Shkoza 07& Marsi	OE i papërgjegjshëm	2,653.56

Nëse pjestojmë vlerën totale të kontratës me çmimin për njësi fitojmë: $760,654.00/1,095.21=694.52$ njësi. Atëherë krahasojmë ofertat si në vijim. Siç mund të shihet diferenca në mes të operatorit fitues dhe ofertës më të lirë është e madhe.

Tabela 20- Krahasimi i ofertave- Regjioni Mitrovica 2

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
ABC & RAD	Operatori performues	1,095.21	694.52	760,654.00
2A&2T&Jubica	OE i papërgjegjshëm	307.17	694.52	231,335.70
Jasen	Fitues në një regjion tjetër	278.94	694.52	193,729.40
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	309.36	694.52	214,856.70
Shkoza 07& Marsi	Tenderues i pasuksesshëm	2,653.56	694.52	1,830,449.13

Regjioni Gjakova 1

MI-ja ka nënshkruar kontratë me OE RSM më 29.11.2018 me çmim për njësi prej 106.62 euro. Vlera totale e kontratës është 1,152,064.88 euro.

Oferta për këtë lot kishin dorëzuar shtatë OE. Tre nga ofertuesit ishin shpallur të papërgjegjshëm, kurse tre të tjerët edhe pse ishin të përgjegjshëm ishin oferta më të shtrenjta se OE i rekomanduar për kontratë nga AK-MI.

Regjioni Gjakova 1 kishte mbetur pa kontratë për mirëmbajtje edhe një vit pas shpalljes së tenderit. Ky lot u dërgua dy herë në rivlerësim nga OSHP-ja pas ankesave të OE Joos & Krasniqi Bazë. Ky OE ishte eliminuar për shkak të listës së paisjeve të sjellura jo sipas kërkesave, por edhe për shkak të çmimit më të lartë se OE i rekomanduar për kontratë. Ndërsa OE Joos & Krasniqi Bazë pretendonte se ishte oferta më e lirë dhe se kushtet tjera për të cilat ishte eliminuar i plotësonte.

AK-MI nuk ndryshonte vendimin e marrë fillimisht dhe në tri proceset e vlerësimit shpalli fitues operatorin e njejtë. Përfundimisht, vendimi i fundit i OSHP-së lidhur me këtë lot, pas ankesës së tretë të OE të eliminuar, ishte në favor të AK-MI-së duke e vërtetuar pretendimin e AK se operatori ankues kishte ofertuar me çmim më të lartë.

|||||

|||||

Nëse e pjestojmë vlerën torale të kontratës me çmimin për njësi fitojmë $601,193.00/835.42=719.62$ njësi. Atëherë krahasojmë ofertat si në vijim.

Tabela 24- Krahasimi i ofertave- Regjioni Gjakova 2

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Victoria Invest International	Performues i kontratës	835.42	719.62	601,193.00
Alko Impex	Fitues në një regjion tjetër	312.10	719.62	224,593.40

Regjioni Peja 1

MI ka nënshkruar kontratë me OE Lika Trade për rajonin Peja 1 më 05.04.2018 me çmim total për njësi prej 2,811.81 Euro. Vlera totale e kësaj kontrate është 908,560.00 euro. Edhe për këtë lot kanë aplikuar vetëm dy operatorë. Oferta e operatorit të suksesshëm ishte oferta më e lirë, ndërsa operatori i pasuksesshëm në këtë lot është fitues në një lot tjetër, ndërsa për këtë lot nuk kishte ndonjë ankesë.

Tabela 25- Krahasimi i ofertave financiare- Regjioni Peja 1

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi
Lika Trade	Performues i kontratës	2,811.81
Victoria Invest International	Fitues në një regjion tjetër	4,832.67

Nëse pjestojmë 908,560.00 me 2,811.81 fitojmë 323.12 njësi. Nëse i krahasojmë ofertat do të kemi:

Tabela 26- Krahasimi i ofertave- Regjioni Peja 1

Operatori Ekonomik	Statusi	Çmimi për njësi	Total njësi	Vlera indikative e kontratës
Lika Trade	Performues i kontratës	2,811.81	323.12	908,560.00
Victoria Invest International	Fitues në një regjion tjetër	4,832.67	323.12	1,561,532.33

Regjioni Peja 2

Regjioni Peja 2 ka mbetur pa kontratë për mirëmbajtje si rezultat i ankesave të vazhdueshme të një operatori ekonomik ndaj vendimit të AK-MI-së për operatorin e rekomanduar për kontratë. Përfundimisht AK-MI lidhi kontratë me OE Graniti në dhjetor 2018, me çmimin për njësi prej 2,887.09 euro. Vlera totale e kësaj kontrate mbërrin në 1,636,035.00 euro.

Në tri vendime radhazi të AK-MI-së, OE Graniti kishte deponuar ankesë në OSHP. Pretendimi ankimor i këtij OE është që OE i

|||||

rekomanduar për kontratë është i papërshtatshëm dhe sipas dispozitave të LPP-së⁶³ ky OE nuk mund të shpërblehet me kontratë publike në periudhë kohore prej 10 viteve. Pretendimin ankimor të OE ankues e mbështet edhe OSHP-ja në vendimet e saj por AK-MI-ja duke mos marrë parasysh vendimet e OSHP-së vazhdon të ta rekomandojë për kontratë të njejtin OE. Pas tri proceseve të rivlerësimit AK-MI më 22.11.2018 kur vendosi për të katërtën herë për këtë lot, kishte ndryshuar vendimin, duke marrë parasysh rekomandimin e OSHP-së. Vlen të theksohet se ky vendim i AK-MI-së është marrë nga zyrtari i ri i prokurimit në këtë ministri.

NDRYSHIMI I ZYRTARIT të prokurimit rezulton me ndryshim të vendimit për operatorin e rekomandar për kontratë.

Kundër këtij vendimi të AK-MI-së kishte deponuar ankesë në OSHP operatori tashmë i eliminuar, por OSHP-ja me vendimin⁶⁴ e datës 13.12.2018 e kishte hedhur poshtë si të palejuar ankesën, duke i dhënë të drejtë AK-MI-së.

Tabela 27- Krahasimi i ofertave financiare- Regjioni Peja 2

Operatori Ekonomik	Statuti	Çmimi për njësi
Graniti	Performuesi i kontratës	2,887.09
Conec Group & El Bau	OE i papërgjegjshëm	677.51
2A Group & 2T & Jubica shpk	Tenderues i pasuksesshëm	677.51
Kag Asphalt&Florida	Tenderues i pasuksesshëm	2,874.37

Duke marrë parasysh që Kontrata për mirëmbajtje të rrugëve e viteve 2014-2017 kishte afatin e përfundimit në nëntor 2017, ndërsa Kontrata për vitet 2017/18/19 është nënshkruar me vonesa të shumta në regjione të ndryshme, shumë regjione kanë mbetur pa mirëmbajtje të rrugëve për periudha kohore të ndryshme. Por, MI gjatë kësaj periudhe "pa kontratë për mirëmbajtje" kishte nënshkruar Kontratë emergjente për mirëmbajtjen dimërore për muajt shkurt dhe mars 2018. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për periudhën kohore që regjionet e ndryshme ishin mbetur pa kontratë për mirëmbajtje të rrugëve.

Tabelë. Të dhëna për periudhën kohore pa kontratë për mirëmbajtje për regjionet e ndryshme

Rajonet	Përfundimi i kontratës të vitit 2014-2017	Nënshkrimi i kontratës 2017-2018-2019	Kontrata emergjente	Periudha pa kontratë
Prishtina A	Nëntor 2017 ⁶⁵	06.06.2018	Shkurt-Mars 2018	4 muaj
Prishtina B	Nëntor 2017	12.07.2018	Shkurt-Mars 2018	5 muaj
Mitrovica A	Nëntor 2017	04.09.2018	Shkurt-Mars 2018	7 muaj
Mitrovica B	Nëntor 2017	12.07.2018	Shkurt-Mars 2018	5 muaj

⁶³ Neni 65 i LPP

⁶⁴ <https://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2018/728-18vend.pdf>

⁶⁵ Raporti i auditorit për procesin e prokurimit për mirëmbajtjen e rrugëve. Faqe 11. <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/07/ProcesiProkurimitPerMirembajtjenRrugeve.212588.pdf> dhe Raporti i KDI-së Rruga tek paratë, sipas të cilit kontratat janë lidhur në nëntor të vitit 2014 për 36 muaj. Faqe.19. <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/54-2016-03-rruga-tek-parate-monitorimi-i-min-se-infrast-alb-isbn.pdf>

ANALIZË E KONTRATAVE

Kontrata për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale 2017/18/19, është kontratë kornizë me disa operatorë, e ndarë në 14 lote dhe e nënshkruar sipas çmimeve për njësi për vlerën indikative sasiore një.

Nga analizimi i çmimeve për njësi të ofruara nga tenderuesit fitues vërehen diferenca të theksuara ndërmjet regjioneve të ndryshme. Këto ndryshime të dukshme në çmimet për njësi të ofertuara nga operatorët e ndryshëm mund të arsyetohen me faktin se regjionet e ndryshme kanë relief të ndryshëm, gjendja e rrugëve nuk është e njëjtë në të gjitha regjionet si dhe frekuentimi i rrugëve nuk është i njëjtë. Në tabelën e mëposhme do të paraqiten dallimet në mes të çmimeve për njësi të kontraktuara në lote të ndryshme nga OE të ndryshëm.

Tabelë. Çmimet për njësi të OE-ve performues të loteve të ndryshme

Regjioni	OE performues	Çmimi për njësi
Prishtina A	Arbotec	280.53
Prishtina B	Integral	444.72
Mitrovica A	Alko Impex	287.13
Mitrovica B	RAD & ABC	1,095.21
Prizreni A	Famis Co	1,101.18
Prizreni B	Drini Company	195.21
Gjakova A	RSM Company	106.62
Gjakova B	Victoria Invest Internacional	835.42
Peja A	Lika Trade	2,811.81
Pejë 2	Graniti	2,887.09
Gjilan A	Tali	498.98
Gjilan B	Jaha Company	377.53
Ferizaj A	Euro kosVia	476.64
Ferizaj B	Damastion Projekt & Arkos	321.9

Gjatë analizimit të çmimeve të ofruara nga OE-të, për punë të ndryshme është vërejtur se janë përdorur edhe çmime jo normalisht të ulëta. Siç mund të vërehet nga tabela e mëposhtme për punë të natyrës së njëjtë janë caktuar çmime të ndryshme, dhe atë për punë më të lehta janë vendosur çmime më të larta kurse për punë më të rënda janë kërkuar çmime më të ulëta.

|||||

Tabelë. Çmime jo normalisht të ulëta dhe çmime më të larta për punë më të lehta.

			Sasia e kërkuar	Çmimi për njësi	Total
Gjakova 1	m2	Riparimi i gropëzimeve, gjurmëve, plasaritjeve të shtreses qarkulluese t= 5 cm.	7,700.00	8	61,600.00
	m2	Riparimi i gropëzimeve, gjurmëve, plasaritjeve të shtreses qarkulluese t= 5 - 10 cm.	5,630.00	0.01	56.3
	m2	Sanimi I dëmtimeve të mëdha 35 - 40 cm trashësi.	1,600.00	0.01	16
			Sasia e kërkuar	Çmimi për njësi	Total
Ferizaj 2	m2	Riparimi i gropëzimeve, gjurmëve, plasaritjeve të shtreses qarkulluese t= 5 cm .	1,200.00	60	72,000.00
	m2	Riparimi i gropëzimeve, gjurmëve, plasaritjeve të shtreses qarkulluese t= 5 - 10 cm.	800	0.2	160
	m2	Sanimi I dëmtimeve të mëdha 35 - 40 cm trashësi.	950	0.1	95

Gjatë analizimit të kontratave janë vërejtur edhe se në regjione të ndryshme OE-të për punë të njejta paguhen ndryshe, në një regjion një punë paguhet 14 euro kurse në një regjion tjetër puna e njejte paguhet 0.20 euro.

Tabelë. Krahasimi i çmimeve të OE-ve të ndryshëm për punë të njejta.

Përshkrimi i punës	Njësia	Regjioni	Sasia indikative sipas DT	çmimi për njësi	çmimi për tërë sasinë
1.3b2) Punimi I shtresës së re qarkulluese, me asfaltbeton AB16 trashësi mesatare prej 60 mm me gryerje, si dhe me përzierje për përforcimin e asfaltit me Aditiv të asfaltit me fibra polimere të Aramidit dhe Polyolefineve.	m2	Prishtina 1	14,000.00	€ 0.95	13,300.00
		Prishtina 2	10,500.00	€ 9.00	94,500.00
		Prizreni 1	16,000.00	€ 9.00	144,000.00
		Prizreni 2	2,000.00	€ 14.00	28,000.00
		Ferizaj 1	3,200.00	€ 5.00	16,000.00
		Ferizaj 2	2,500.00	€ 0.20	500
		Gjilan 1	36,160.00	€ 8.00	289,280.00
		Gjilan 2	19,680.00	€ 8.50	167,280.00
		Mitrovica 1	30,450.00	€ 7.90	240,555.00
		Mitrovica 2	10,800.00	€ 6.00	64,800.00
		Gjakova 1	17,300.00	€ 8.00	138,400.00
		Gjakova 2	9,100.00	€ 8.00	72,800.00
		Peja 1	41,195.00	€ 7.50	308,962.50
		Peja 2	25,000.00	€ 9.00	225,000.00

E njejta dukuri (ku për punët e njejta ndryshimi i çmimeve është shumë i madh, ndërmjet OE-ve të ndryshëm) është vërejtur edhe në një rast tjetër të pasqyruar në tabelën më poshtë. Gjithashtu në këtë tabelë mund të shihet që OE fitues për Lotin Gjakova 1 në ofertën e tij ka përfshirë çmimin për orë të punëtorëve të kualifikimeve të ndryshme prej 0.01 euro.

|||||

Duke marrë parasysh këtë fakt, konsiderojmë që AK-MI duke u bazuar në këtë përvojë, është dashur t'a vendoste një klauzolë të njejtë në dosjen e tenderit për këtë kontratë dhe t'a zbatonte atë. Pasi nuk n'a është dhënë qasje në raporte të inspektimit për operatorët performues të kontratës aktuale, nuk mund të konkludojmë nëse këta operatorë i përmbushin ose jo kërkesat e DT-së.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur operatorët fitues të kontratës paraprake dhe të kontratës aktuale, ndërsa në kolonën e fundit tregohet se cilët nga operatorët performues të kontratës së kaluar sipas raporteve të inspektimit të bëra pas nënshkrimit të kontratës kishte dalë që nuk i plotësonin kërkesat e pajisjeve të detyrueshme teknike dhe kërkesave tjera të theksuara në specifikacionin teknik të detyrueshëm.

Tabelë: Krahasimi i operatorëve performues ndërmjet kontratës së vitit 2014-15-16 dhe 2017-18-19

Rajonet	Operatori fitues në kontratën e kaluar	Operatori fitues në këtë kontratë	Krahasimi 2014 me 2017	Raportet e inspektimit per kontratën e vitit 2014
Prishtina 1	Arbotec	Arbotec	OE i njejtë	Nuk i plotëson kushtet e DT
Prishtina 2	Integral	Integral	OE i njejtë	Nuk i plotëson kushtet e DT
Mitrovica 1	Alko Impex	Alko Impex	OE i njejtë	Nuk i plotëson kushtet e DT
Mitrovica 2	Jasen	RAD & ABC	OE i ndryshëm	-
Prizreni 1	Famis Co	Famis Co	OE i njejtë	Nuk kishte vërejtje
Prizreni 2	Drini Company	Drini Company	OE i njejtë	Nuk kishte vërejtje
Gjakova 1	Victoria Invest	RSM	OE i ndryshëm	Nuk i plotëson kushtet e DT
Gjakova 2	RSM	Victoria Invest Internacional	OE i ndryshëm	Nuk i plotëson kushtet e DT
Peja 1	Lika Trade	Lika Trade	OE i njejtë	Nuk ka vërejtje
Pejë 2	Graniti	Graniti	OE i njejtë	Nuk ka vërejtje
Gjilan 1	Tali	Tali	OE i njejtë	Nuk ka vërejtje
Gjilan 2	Jaha Company	Jaha Company	OE i njejtë	Nuk i plotëson kushtet e DT
Ferizaj 1	Euro KosVia	Euro Kosvia	OE i njejtë	Nuk i plotëson kushtet e DT
Ferizaj 2	Damastion Projekt & Arkos	Damastion Projekt & Arkos	OE i njejtë	Nuk i plotëson kushtet e DT

|||||

Meqenëse kontrata e kaluar për mirëmbajtje kishte afatin e skadencës në nëntor 2017, ndërsa MI kishte filluar me procedurën e rregullt të prokurimit për Kontratën për mirëmbajtjen e rrugëve për vitet 2017, 18 dhe 19 nga data 29 shtator 2017, por për shkak të ankesave të OE-ve në OSHP, ky proces u vonua, MI me procedurë të negociuar **pa publikim të njoftimit për kontratë** kishte lidhë kontratë me 14 OE për periudhën kohore shkurt-mars 2018.

Këto kontrata janë lidhë me operatorët performues të kontratës që ishte në skadim, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 52.6 të RRUOPP-së sipas të cilit AK duhet të ftojë OE dhe të zgjedhë fituesit në mesin e OE-ve të përshtatshëm.

NJOFTIMI PËR NËNSHKRIMIN e kontrates emergjente nuk është publikuar në platformën e-prokurimi përkundër obligimit ligjor.

Njoftimi për nënshkrimin e kësaj kontrate nuk është publikuar në platformën e-prokurimi përkundër obligimit ligjor, ndërkohë që ky njoftim për nënshkrim të kontratës është publikuar në web faqen e KRPP-së por mund të gjindet vetëm nëse kërkohet tek dokumentet e vitit 2014.

Nga të dhënat e publikuara në njoftimin për nënshkrim të kontratës shihet që kontratat janë lidhur me **çmim fiks**, e kjo paraqet ndryshim nga kontratat që lidhen me procedurë të rregullt që lidhen sipas **çmimit për njësi me sasi** indikative një.

Nga krahasimi i çmimeve për sasi të indikative të kontratës emergjente dhe kontratës së rregullt mund të shihet se MI ka paguar **293,512.91** më shumë për mirëmbajtjen dimërore në kontratën emergjente se sa do të paguante sipas kontratës së rregullt.

MI KA PAGUAR 293,512.91 më shumë për mirëmbajtjen dimërore në kontratën emergjente se sa do të paguante sipas kontratës së rregullt.

|||||

KONKLUSIONE

- Infrastruktura rrugore konsiderohet si aset më i rëndësishëm publik që i kontribuon zhvillimit ekonomik dhe atij shoqëror. Mirëmbajtja e rrugëve duhet trajtuar si aktivitet i pashmangshëm dhe esencial në shërbim të këtyre qëllimeve dhe në evitim të shpenzimeve enorme për riparimin e tyre. Procesi i prokurimit për mirëmbajtje të rrugëve duhet të bëhet sa më herët në kohë për të evituar situata kur për shkak të ankesave dhe vonesave në tenderim rrugët mbesin pa mirëmbajtje duke cenuar kështu sigurinë e qytetarëve dhe mallrave në rrugë.
- Procesi i tenderimit për këtë kontratë ka zgjatur për më shumë se një vit si rrjedhojë e ankesave të shumta të OE lidhur me vendimet e AK-MI për dhënie të kontratës. Për shkak të mos shqyrtimit adekuat të ankesave nga ana e MI këta operatorë kanë deponuar ankesa në OSHP dhe kjo ka ndikuar në zgjatjen e procesit të prokurimit e si rrjedhojë edhe mbetjen e rrugëve pa mirëmbajtje. Shumë ankesa të refuzuara nga MI si të pabazuara, janë aprovuar nga OSHP si të bazuara.
- MI nuk publikon të gjitha njoftimet për aktivitetet e prokurimit në platformën e e-prokurimit. Për kontratën emergjente nuk ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës, ndërsa njoftimin për nënshkrim të kontratës është publikuar në web faqen e KRPP-së tek arkiva e njoftimeve. Ndërsa për kontratën e rregullt për mirëmbajtje MI nuk ka publikuar asnjë nga Njoftimet për nënshkrim të kontratës, apo kontratat megjithëse janë nënshkruar 14 kontrata.
- Procesi i prokurimit për këtë kontratë, qysh në fillim, është vonuar për tre muaj për shkak se MI në Dosjen e Tenderit ka aplikuar kritere diskriminuese, të cilat më vonë me vendim të OSHP-së janë konsideruar si kritere favorizuese dhe MI është obliguar që të largoj ato.
- Vonesat në procedurën e tenderimit kanë detyruar MI-në të lidhë kontratë emergjente për mirëmbajtjen dimërore për të cilën sipas llogaritjeve tona ka paguar çmim më të lartë për 289,326.27 euro krahasuar me çmimin që do ta paguante sipas kontratës së rregullt.
- Kufizimi i vënë nga MI-ja që një OE mund të përzgjedhet fitues vetëm në një lot, ka bërë që oferta e një OE-je edhe pse ka qenë oferta më e lirë në më shumë se një lot, nuk ka mundur të përzgjedhet fitues në të gjitha ato lote, kështu MI në lote të ndryshme ka përzgjedhur fitues OE-të që kanë qenë më të shtrenjtë. Shembull konkret mund të merret Loti Prizreni 1. Në këtë lot është përzgjedhur fitues Famis Co HC me çmim për njësi prej 1,101.18 euro, kurse oferta e Alko Impex prej 308.18 euro për njësi nuk është përzgjedhur fitues pasi që ishte përzgjedhur fitues në një lot tjetër. Raste të njejta kur OE fitues nuk ka qenë OE me ofertën më të lirë ka në shumicën e loteve. Përveç kësaj që u cek më lartë, në këso rrethana ekziston mundësia edhe e marrëveshjeve të ndryshme të OE-ve, për ndarje të regjioneve. Nëse një OE do të mund të shpallej fitues në më shumë se një lot atëherë mundësia e marrëveshjeve të OE-ve lidhur me ndarjet e regjioneve do të zvogëlohej dhe do të kishte kursim të buxhetit duke përzgjedhur fitues OE-të me çmime më të lira në më shumë se një regjion.
- Meqenëse kemi të bëjmë me kontratë me çmime për njësi sipas RUOPP neni 56.11 AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve apo artikulli", në mënyrë që të përcaktohet se cila është oferta me çmimin më të ulët. Në rastin konkret tek kontrata për mirëmbajtje të rrugëve, MI nuk ka përdorur poentimin.
- Ministria e Infrastrukturës nuk është treguar kënaqshëm transparente sa i përket ofrimit të qasjes në dokumente që lidhen me këtë tender. Nga shtatë kërkesa të dërguara për qasje në dokumente publike në departamentet përkatëse, katër kanë rezultuar me përgjigje.⁶⁹ Zyra për prokurim publik dhe Drejtoria për Menaxhim të Rrugëve konsiderohen më bashkëpunuese

⁶⁹ Departamenti për Menaxhim të rrugëve është përgjigjur në kërkesën për qasje, ndërsa Zyrës së prokurimit publik i'u janë dërguar dy kërkesa për qasje në të cilat është përgjigjur dhe ka ofruar qasje në dokumentet e kërkuara (përveq Planit të Prokurimit dhe Aneks kontratave).



në dhënie të qasjes në informata, për dallim nga Departamenti për Financa⁷⁰ dhe Departamenti për Inspektoriat⁷¹ të cilët nuk kanë ofruar dokumentet e kërkuara. Një kërkesë i'u është drejtuar edhe departamentit për komunikim me publikun për procedim të mëtejshëm tek departamenti përkatës, por as kjo kërkesë nuk ka marrë përgjigje.

- Vendimet e OSHP-së nuk respektohen nga AK-MI. Rast konkret është kur MI dy herë radhazi injoron vendimin e OSHP-së duke vazhduar ta rekomandoj për kontratë operatorin që sipas vendimit të OSHP-së ishte i papërgjegjshëm. Vetëm pas vendimit të tretë me radhë të OSHP-së, MI ka vendos siç është kërkuar në vendim të OSHP-së.

70 Dokumentet që janë ofruar nga ky departament nuk kanë qenë dokumentet që KDI ka kërkuar. Edhe pasi që është përsëritur kërkesa ndaj këtij departamenti, përgjigje ka munguar.
71 Kërkesës për qasje në dokumente ky departament nuk i është përgjigjur.





REKOMANDIMET PËR OSHP

- Vendimet e OSHP-së duhet të merren në afate më të shkurta kohore gjithnjë konform dispozitave ligjore të LPP.
- Ekspertët shqyrtues duhet të bëjnë shqyrtimin e detajuar të pretendimit ankimor të OE-ve dhe vendimet finale të OSHP-së duhet të jenë sa më konkrete.
- OSHP duhet ta penalizoj ose të nxjerr urdhër ndaj Autoritetit Kontraktues i cili nuk i respekton vendimet e saj dhe nuk është bashkëpunues gjatë kohës kur ndonjë aktivitet është në procedurë në OSHP.



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.
Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy
Pristina